



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.383/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” sh.a me seli në Mitrovicë me nr.NRB ..., ndaj debitorit DPZ “M...” me pronar I.U. NUI;... nga Vushtrria, rr.F.B. , duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, CPP.nr.280/21 të datës 26.08.2021, me datën 09.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit DPZ “M...” me pronar I.U. NRB ... nga Vushtrria, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega ne Vushtrri, CPP.nr.280/21 të datës 26.08.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega ne Vushtrri, me aktvendimin e ankimuar CPP.nr.280/21 të datës 26.08.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit DPZ “M...” me pronar I.U. nga Vushtrria, të paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa, për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.2458/19 te datës 03.12.2019.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës kontestimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e ankimuar ta prish pjesërisht dhe lëndën ta kthej në rivendosje ose aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit VU.1.B.28.810344. Përmbaruesi privat Atip Mustafa nga Mitrovica sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.2458/19 të datës 03.12.2019, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të detyrimit në lidhje me marrjen e shërbimit për heqjen e mbeturinave t'i paguaj shumën prej 177.80, me kamatën prej 8% nga data e paraqitjes së propozimit deri te pagesa definitive.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 12.12.2019, duke pretenduar se propozimi për përmbarim është i paargumentuar dhe i pabazuar sepse kreditori nuk ka cekur rrjedhën e borxhit si dhe nuk specifikon vitin kur kanë filluar të rrjedhin detyrimet. Shuma të cilën e kërkon kreditori nuk është reale dhe asnjëherë nuk është faturuar. Punëtorja e biznesit B... është në të njëjtën shtëpi familjare ku banon edhe pronari me ç 'rast mbeturinat e biznesit hidhen në të njëjtën kantë mbeturinash. Kreditori në mënyrë paushallë ka vendosur shumën e detyrimit të debitorit pasi punonjësit e kreditorit asnjëherë nuk më kanë faturuar por përnjëherë kanë kërkuar pagesën e borxhit. Kreditori gabimisht ka arsyetuar pasqyrën e borxhit duke mos sqaruar plotësisht një mori rrethanash që lidhen me këtë çështje. Debitori asnjëherë nuk ka lidhur marrëveshje me kreditorin për grumbullimin e plehrave. Propozon që gjykata ta pranoj këtë prapësim, ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datën 16.12.2019 , me arsyetimin se procedura përmbarimore ka filluar dhe është bazuar në faturat apo ekstraktet e kreditorit KRM "Uniteti" sh.a te cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin duke u mbështetur në frymën e nenit 40 të LPP, propozon që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin CPP.nr.280/21 te datës 26.08.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se nga ekstrakti i pretenduar në raport me debitorin në shumën prej 177.80 euro, shuma e borxhit është evidente dhe debitori nuk ka përmbushur në tërësi detyrimin ashtu që ka mbetur borxhi prej 177.80 euro. Kreditori ka vepruar bazuar në nenin 8 dhe 245 par.1 dhe 2 të LMD. Nga shkresat në lëndë gjykata ka gjetur se debitori ka marrë shërbimin nga kreditori dhe nuk ka përmbush detyrimin dhe periudha për të cilën kërkohet përmbarimi është mese i qartë dhe përfshin periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 31.10.2019, faturimi konstatohet se është bërë rregullisht ku konstatohen edhe pagesat e bëra nga debitori në shumat e zbatuara. Ashtu që nga shuma prej 242.60 euro ka bërë pagesën prej 64.80 euro duke mbetur shuma e detyrimit prej 177.80 euro.

Konstaton se kreditori ka evidentuar numrin fiskal të debitorit NUI... ashtu që është i panevojshëm kthimi në plotësim i propozimit për përmbarim sipas rekomandimit të Gjykatës së Apelit, me vet faktin se debitori ka bërë pagesa të mbeturinave i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për detyrimin e përmbushjes mujore të shërbimit në emër të mbeturinave i faturave përkatëse, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkalle së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkalles së Dytë, po ashtu vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: *”Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është Ekstrakti i nga libri afarist VU.1.B.28.810344, për shumën e detyrimit prej 177.80 euro dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbarim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 21 dhe 29 par.1 pika 2 dhe 3 të LPP - së. Gjykata e shkalles së dytë vlerëson se pretendimi i debitorit se i njëjti nuk ka marrëveshje me kompaninë e mbeturinave, ndërsa si biznes i vogël/punëtori, mbeturinat eventuale i proceson përmes shërbimit të mbeturinave që i përdorë për amvisëritë e tij pasi shtëpia dhe punëtoria janë në një ndërtesë/shtëpi, nuk qëndron ky pretendim sepse nga shkresat e lëndës përkatësisht ekstraktet e cila gjindet në lëndë del se debitori ka bërë pagesa edhe më parë për shërbimet e marra nga kreditori dhe atë në mënyrë të herëpasëherëshme, dhe se debitori ka qenë i vetëdijshëm për detyrimin e përmbushjes mujore të shërbimit në emër të mbeturinave sipas ekstrakteve përkatëse. Po ashtu sa i përket pretendimet të debitorit se borxhi i tij është parashkruar-shkrirë dhe se me këtë kreditori e ka humbur të drejtën që me mjete të dhunës të realizoj kërkesën e vet, nuk qëndron, e kjo bazuar në nenin 355 i LMD par.1 i cili thotë se: *”kërkesat reciproke nga kontrata komerciale si dhe kërkesa e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata parashkruhen për tre (3) vite”*, ndërsa par.2 thotë se *”parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbim të kryer”*, ndërsa neni 368 i LMD par.1 thotë se *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”* ndërsa par.2 thotë *“pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”* e që në rastin konkret në bazë të shkresave në lëndë rezulton se që nga muaji Tetor 2015 e deri me datën

01.01.2019 debitori ka bërë disa pagesa ndaj kreditorit në emër të shërbimeve të heqjes së mbeturinave, me çka konsiderohet se është bërë pranimi i borxhit dhe ndërprerja e parashkrimit në kuptim të dispozitës së lartcekur, shtoj kësj edhe faktin se debitori është subjekt afarist dhe jo person privat. Pretendimi i debitorit se Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërej se debitori asnjëherë nuk është faturuar me rregull dhe se kreditori ka vendosur në mënyrë paushalle këtë shumë të detyrimit, nuk qëndron sepse nga ekstraktet e kreditorit të bashkangjitura propozimit për përmbarim shihet qartë se faturimi është bërë në vazhdimësi, e kjo bazuar nga fakti se kreditori nga shuma totale e borxhit për muaj dhe vite ka bërë zbritjet e pagesave të kryera nga debitori, deri në detyrimin sipas ekstraktit të fundit ku me pagesën e kryer nga debitori të shumës prej 64.80 euro detyrimi i debitorit ndaj kreditorit në shumën 242.60 euro zbritet në shumën prej 177.80 euro si detyrim i mbetur për pagesë. Andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të debitorit janë vetëm deklarative dhe të pabazuara lidhur me gjendjen faktike dhe lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe si të tilla rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi që ta vërtetojë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.383/22, me datë 09.11.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri